



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 17 Datë 10.05.2007

PËR
MIRATIM FONDI PREJ 112.500 LEK PËR RITJEN E
SHPËRBLIMIT TË BANDËS SË QYTETIT KORÇË.

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Financës për "MIRATIM FONDI PREJ 112.500 LEK PËR RITJEN E SHPËRBLIMIT TË BANDËS SË QYTETIT KORÇË", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal" neni 6, Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e shpërblimit për Bandën e qytetit nga 3500 lek/person në 4000 lek/person, (25 persona * 500 lekë * 9 muaj = 112.500 lekë).

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet 00 04980 5 Art 6091100 - 112 500 lekë

Shtohet 00 08250 5 Art 6020000 + 112 500 lekë

3. Efektet financiare do të fillojnë që nga 1 Prilli 2007 e në vazhdim.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sektori i Kulturës në Bashki dhe Qendra Ekonomike e Kulturës.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetare e Këshillit

Rajmonda NASE
Rajmonda NASE